



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:177234
Datë: 16.10.2024
Numri i dokumentit: 06305333

Ac.nr.795/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.K, nga komuna Prizren, të cilën e përfaqëson me autorizim B.K, avokat me seli në Komuna Prizren, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, në çështjen për shkak të kompensimit të shujtave për ditët në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2655/23 datë 06.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2655/23 datë 06.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2655/23 datë 06.10.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.K nga Prizreni.

*II.DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëses E.K, t'ia paguajë kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për vitin 2022 deri me datë 21.11.2022 dhe atë për 157 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro për një ditë pune, gjithsej vlerën e përgjithshme prej **314.00 € (treqind e katërmbëdhjetë euro)** dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes*

së padisë (21.08.2023) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III.DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 124 € (njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm... ”.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar të paditurës, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar të prishet aktgjykimi, dhe të hedhet poshtë padia e paditëses apo të ndryshohet aktgjykimi ose aktgjykimi i ankimuar të prishet dhe çështja kontestuese të kthehet në rivendosje në Gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja E.K, nga Komuna Prizren, me datë 21.08.2023, ka ushtruar padi për kompensimin e shujtave ditore, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale për Arsim në Prizren.

Gjykata e shkallës së parë me datë 06.10.2023, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.2655/23, me të cilin ka vendosur që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar si vijon: “... gjykata gjeti se e paditësja për periudhën kohore gjatë vitit 2022 saktësisht deri me datë 21.11.2022 ka qenë e pranishme në punë për 157 ditë, fakt ky i vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni ku paditësja punon. Duke u nisur nga fakti se e paditura paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit e detyroi të paditurën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi...”.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe atë se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune mësimdhënëse tek e paditura, SHFMU “Lidhja e Prizrenit”, në Prizren. Nga vërtetimi 83/23 të datës 03.05.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësja, në periudhën e vitit 2022 saktësisht deri me datë 21.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 157 ditë pune, andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit shumë më si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Lidhur me shumën e kompensimit të ushqimit në punë, Gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitën e nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se: *“...Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*, e cila Kontratë është lidhur dhe është nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, si dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës, dhe Kulturës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadiisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për shpenzimet e ushqimit në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Gjykata e Apelit, mori parasysh pretendimin ankimor të të paditurës lidhur me faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruerit e kësaj kontrate siç janë

MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Lidhur me këto pretendime, Gjykata e Apelit vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedh se obligimi për përmbushjen e të drejtave të të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, përfshirë të drejtën për kompensim të ushqimit, i takon pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëses, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë, ndërsa në nenin 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat - DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...”*, ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.795/2024 datë 15.10.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi